



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

**Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të
Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, Ekonomisë
Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.**

Raport vendimmarrjeje

Nr 6 /Datë 28.01. 2026

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

**“NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.127,DATË 22.12.2025 ,MIRATIMIN E
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË
POGRADEC (FAZA III) DHE TAVANEVE PËRFUNDIMTARE
BUXHETORE PËR VITET 2026-2028”** shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet
perkatëse.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 41, pika 1 dhe pika 2 shkronja “d”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar, nenit 36 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 16.05.2024, “Për një shtesë në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar”, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQV” të

ndryshuar, Udhëzim Nr.8 datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028” me shtojcat plotësuese ,shkresa nr. 937/20 prot dt 09.12.2025 për procesin e konsultimit publik ,shkresës së Prefektit të Qarkut Korçë nr.5/1 prot. datë 12.01.2026 Këshilli Bashkiak:

Situata aktuale e funksionit:

Miratimi per ndryshimin e Vendimit nr.127,datë 22.12.2025 ,Miratimin e Tavanëve Përfundimtare Buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (faza III) të Bashkisë Pogradec, për vitet 2026-2028 sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028) sipas detajimit dhe dokumentave të pasqyruar në projektvendim.

Situata financiare:

Sipas dokumentacionit/relacionit që shoqëron projekt vendimin

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

DREJTORIA E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Monitorimi dhe raportimi:

DREJTORIA E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Këshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Qytetare të bashkisë Pogradec

A është objekt i konsultimit publik? Jo

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikëqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 28.01. 2026, shqyrtoi projektvendimin “NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.127,DATË 22.12.2025 ,MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË POGRADEK (FAZA III) DHE TAVANEVE PËRFUNDIMTARE BUXHETORE PËR VITET 2026-2028”. Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Këshillit bashkiak:

a- (Miratimin e projektaktit.

b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.

c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.

d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gelmuk Hashellari
(emri, mbiemri, firma)



Kryetar i komisionit

Himoza Shuli
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i komisionit

Datë: 28.01. 2026